

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR

**FUNKSIONIMIN E SHËRBIMEVE TE POLICISË GJYQËSORE NE DREJTORINË
E PËRGJITHSHME TE DOGANAVE**

Mbështetur ne nenin 17, le Ligjit Nr.8677, date 02.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" dhe te ligjit Nr.8449 date 27.01.1999, "Për Kodin Doganor"

UDHËZOJMË:

1. Ne zbatim te nenit te nenit 9, te Kodit Doganor dhe te nenit 6, te Ligjit Nr. 8677 date 02.11.2000, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore", Departamenti Hetimor dhe Operativ ne Drejtorinë e Përgjithshme te Doganave është shërbim i Policisë Gjyqësore.
 - 1.1 Punonjësit e Departamentit Operativ Hetimor do te kenë atributet e Policisë Gjyqësore, dhe do te kryejnë detyrat sipas këtyre attributeve rast pas rasti, ne baze te urdhrave te dala nga Titullari urdhërues.
- 2 Shërbimi i Policisë Gjyqësore ne Departamentin Operativ Hetimor ne Drejtorinë e Përgjithshme te Doganave ushtrojnë veprimtarinë e tyre " procedurale ne gjithë territorin e vendit, e ne çdo rast brenda juridiksionit dhe nen drejtimin e Prokurorisë kompetente.
3. Shërbimit te Policisë Gjyqësore gjate veprimtarisë se tyre procedurale, ruajnë hierarkinë qe kane ne ndërtimin administrativ te strukturave te Administratës Doganore.
4. Drejtuesit e shërbimeve te Policisë Gjyqësore ne Drejtorinë e Përgjithshme te Doganave përgjigjen përpara Prokuroreve qe drejtojnë hetimet, për zbatimin e detyrave prej vartëseve te tyre dhe para organit epror te strukturave organizative kompetente ku bën pjese.
5. Me autorizim te Prokurorit qe drejton hetimet, drejtuesit e shërbimeve te Policisë Gjyqësore kontrollojnë realizimin dhe afatet e zbatimit te detyrave, te urdhëruara dhe/ose te deleguara prej Prokurorit.

6. Drejtuesit e shërbimit të Policisë Gjyqësore u paraqesin menjëherë titullarëve të Prokurorive kompetente, listën emërore të oficerëve të Policisë Gjyqësore që janë në vartësi të tyre, duke përcaktuar funksionin dhe profilizimin e secilit. Kjo listë miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave si dhe Prokurori i Përgjithshëm.
7. Drejtuesit e shërbimit të policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave njoftojnë 10 dite përpara drejtuesit të Prokurorive kompetente, në rastet kur transferohen oficeret e Policisë Gjyqësore për nevojat pune, kur gjykohet bashkërisht se transferimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore në Administratën Doganore mund të sjellin pasoja në ecurinë e hetimeve, vendoset pezullimi përkohësisht i transferimeve, deri në përfundim të hetimeve.
8. Oficeret dhe Agjentët e shërbimit të Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave realizojnë veprimtarinë e tyre procedurale me iniciative, urdhërim apo delegim të Prokurorit, dhe mbajnë përgjegjësi për zbulimin, hetimin dhe dokumentimin në rrugë procedurale të veprave penale që iu dërgohen.
9. Aktet procedurale të përpiluara nga Oficerët dhe Agjentët të Policisë Gjyqësore, i referohen Prokurorit kompetent, sipas mënyrës dhe kërkesave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Këto akte dërgohen menjëherë bashkëlidhur një shkresë të titullarit të Administratës Doganore ku janë kryer veprimet procedurale, por jo më vonë se 24 ore nga momenti i marrjes dijeni për veprën penale.
10. Gjate fazave të hetimeve paraprake, hetimit gjyqësorë e deri sa gjykata jep vendim të formës së prere, Oficerët e Policisë Gjyqësore që hetojnë apo kanë kryer hetimet, përgjigjen përpara Prokurorëve kompetent, për kryerjen me cilësi të detyrave që mund t'u ngarkohen në vazhdimësi.
- 10.1 Kur prokurori I ceshtjes dhe drejtuesi i shërbimit të Policisë Gjyqësore vlerësojnë të nevojshme, Oficerët e Policisë Gjyqësore që kanë kryer hetimet marrin pjesë edhe gjate seancave të hetimit gjyqësor për të ndihmuar Prokurorinë në paraqitjen e provave.
- 10.2 Për ecurinë e hetimeve si dhe para marrjes së vendimeve për pushim. Pezullimin apo dërgimin për gjykim të procedimeve penale Prokurori kompetent organizon analizë në të cilat raportojnë drejtuesit dhe oficerët e shërbimit të Policisë Gjyqësore që kanë bërë hetimin.
- 10.3 Në rastet kur në të njëjtat hetime janë përfshirë edhe oficerët e seksioneve të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorive, respektohen kërkesat e përcaktuara në pikat 10/10.1/10.2, të këtij Udhëzimi.

11 Shërbimi i Policisë Gjyqësore në Administratën Doganore dhe seksionet e Policieve Gjyqësore pranë Prokurorive çdo tre muaj shkëmbejnë informacione ndërmjet tyre për çështje që lidhen me:

- Gjendjen e përgjithshme të kriminalitetit;
- Tendencat me shqetësuese të tij;
- Marrjen e masave parandaluese;
- Si dhe çdo problem tjetër që është me interes, në kuadrin e përgjithshëm të punës për parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit.

12. Shkëmbimi i ndërsjelle i informacioneve, ndërmjet shërbimit të Policisë Gjyqësore në Administratën Doganore dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorive, realizohet për verifikime që lidhen me:

- Implikime të tjera për autorin/et të tjerë të veprës penale në fushën doganore;
- Veprave penale në fushën doganore;
- Rrethana apo të dhëna të reja në funksion të procedimit penal;
- Si dhe për marrjen e detyrimeve reciproke të përbashkëta ose të bashkërenduara.

12.1 Veprimtaria e përmendur në pikën 12 të këtij Udhëzimi, realizohet nën autoritetin dhe drejtimin e Prokurorit kompetent, në përputhje me normat e vendosura në Kodin e Procedurës Penale.

13 Prokuroritë e ngritura pranë Gjykatave të Shkalles së Parë çdo vit, në bashkëpunim me drejtuesit e shërbimit të Policisë Gjyqësore në Administratën Doganore, planifikojnë dhe marrin masa për organizimin bashkërendim dhe kryerjen e veprimtarive që kanë për qëllim, edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm juridik e profesional të Oficerëve dhe Agjenteve të Policisë Gjyqësore.

14. Të gjithë punonjësit e Departamentit Operativ Hetimor, të niveleve, të ndryshme që nuk përfshihen në shërbimin e Policisë Gjyqësore kanë atributet e Policisë Gjyqësore në përputhje me ligjin 8677, datë 02.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" si dhe të Ligjit 8449 datë, 27.1.1999 Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë.

14.1 Punonjësit e Departamentit Operativ Hetimor të përmendur në pikën 14 të këtij Udhëzimi, marrin detyrime dhe veprojnë sipas nevojave të shërbimit të Policisë Gjyqësore, krahas zbatimit të detyrave funksionale si punonjës të doganës.


15. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë Prokurorët, personeli i seksionit të Policisë Gjyqësore si dhe Punonjësit e Departamentit Operativ Hetimor.

16 Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Prokurorët, drejtuesit e seksioneve, të shërbimit të Policisë Gjyqësore, si dhe Oficerët dhe Agjentët e Policisë Gjyqësore të Administratës Doganore.

17 Për kontrollin e zbatimit të këtij Udhëzimi ngarkohen Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroritë e ngritura pranë Gjykatave të Shkalles së Parë, Prokuroritë e Apelit, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

18. Ky udhëzim i përbashkët hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE



PROKURORI I PËRGJITHSHEM



